



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-064
Prishtinë, më 18 dhe 25 2016

P R O C E S V E R B A L

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 18 DHE MË 25 MAJ 2016

Mbledhjen e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmuan Xhavit HALITI dhe Sabri HAMITI, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kuvendi i zhvilloi punimet sipas pikave të rendit të ditës, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Bekim Haxhiu, Duda Balje, Nenad Rashiq, Agim Aliu, Emiljija Rexhepi, Xhevair Izmaqi, Danush Ademi dhe Zenun Pajaziti, të cilat janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Abdyl Ymeri parashtoi pyetje për ministrin e Kulturës, z. Kujtim Shala, lidhur me krijimin e kushteve rinisë për aktivitete sportive dhe kulturore. Ministri nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputetja Alma Lama parashtoi pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, z. Skender Hyseni, në lidhje me atë se sa ka ndikuar Ligji për ndalimin e bashkimit në konfliktet e

armatosura jashtë territorit të Kosovës në zvogëlimin e numrit të të rinjve nga Kosova për t'iu bashkuar luftës në Siri.

Ministri nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti Slavko Simiq parashtroi pyetje për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Arban Abrashi, në lidhje me atë se në bazë të të cilit udhëzim është duke u zbatuar kushtëzimi me dëshmitë e faturave të shërbimeve komunale për realizimin e së drejtës për pension themelor?

Ministri Arban Abrashi iu përgjigj deputetit Slavko Simiq.

Deputeti Raif Qela parashtroi pyetje për ministrin për Komunitete dhe Kthim, z. Dalibor Jevtiq, në lidhje me atë se sa ka kontribuar kjo ministri për kthimin e qytetarëve shqiptarë të Kosovës, të dëbuar nga pronat e veta, për t'u kthyer në banesat dhe shtëpitë e tyre në komunën e Mitrovicës Veriore?

Ministri Dalibor Jevtiq iu përgjigj deputetit Raif Qela.

Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli parashtroi pyetje për ministrin e Financave, z. Abdullah Hoti, se përse nuk u është ndarë Kodi buxhetor për teatrot e qyteteve të Republikës së Kosovës, sipas Ligjit për teatrot?

Ministri Abdullah Hoti iu përgjigj deputetes Mexhide Mjaku-Topalli.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra parashtroi pyetje për ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Arban Abrashi, në lidhje me atë se çfarë ndryshimesh parashihen të bëhen në projektligjin e ri lidhur me pushimin e lehonisë?

Ministri Arban Abrashi iu përgjigj deputetes Blerta Deliu-Kodra.

Pati edhe pyetje të tjera, por për mungesë të ministrave ato u shtynë për seancën e radhës.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 24 mars 2016, në orën 10:00, dhe më 24 mars 2016, në orën 17:30, si dhe më 30 mars 2016.

* * *

Kryetari i GP të LDK-së, Ismet Beqiri, propozoi që pika e 13-të e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e lartshënuar.

Kuvendi me 65 vota e shtyu pikën e 13-të: Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës për seancën e radhës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit

Kryetari i njoftoi deputetët se Kuvendi duhet të deklarohet për propozimin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa që shqyrtimi i këtij projektligji të bëhet me procedurë të përshpejtuar.

Kryetari i Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, e paraqiti dhe e arsyetoi propozimin e komisionit.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 57,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit bëhet me procedurë të përshpejtuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 56, paragrafi 1 dhe më nenin 57, paragrafët 3, 8 dhe 9 të Rregullores së Kuvendit, si në vijim:

1.1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit bëhet në seancën plenare, më 18 maj 2016.

1.2. Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme, duhet ta përfundojnë shqyrtimin e Projektligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit jo më vonë se më 23 maj 2016.

1.3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit bëhet në seancën plenare jo më vonë se më 25 maj 2016.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Pastaj, kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave, z. Abdullah Hoti, e paraqiti dhe e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit Projektligjit nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Lidhur me Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit diskutuan: Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së dhe nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim miratimin në parim të këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----59,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

2. Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme: Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsioni, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim dhe Komisioni për Integritet Evropian duhet ta shqyrtojnë projektligjin në pajtim me vendimin nr. 05-V-271, datë 18 maj 2016, dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Votimi i Projektligjit për Akademinë e Drejtësisë

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 29 prill 2016. Por, për mungesë të kuorumit nuk është proceduar për votim.

Ai e hodhi në votim projektligjin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----59,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për patentë shoferi

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional dhe Komisioni për Legjislacion, në pajtim me vendimin e Kuvendit, datë 30 mars 2016, i kanë harmonizuar qëndrimet për amendamentet e propozuara në Projektligjin për patentë shoferi dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Deputetin Raif Qela, në emër të Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime. Në këtë projektligj ishin paraqitur 106 amendamente.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim në tërësi 104 amendamente, ndërsa amendamentet 29 dhe 56 u hodhën në votim veçmas. Kuvendi i miratoi amendamentet e lartshënuara.

Në fund, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----61,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për patentë shoferi.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike, z. Ali Sadriu, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime.

Në këtë projektligj ishin paraqitur 18 amendamente

Pastaj, kryetari i hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara. Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5 (b) i Komisionit për Buxhet dhe Financa, 6,7,8,9, 10,11,12,13,14,15,16,17 dhe 18.

Në fund, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----60,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

8. Votimi i anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë, si dhe për pikat në vijim: 9, 10 dhe 11 kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 29 prill 2016. Andaj, në seancën e sotme procedohet vetëm me votimin e tyre.

Ai e hodhi në votim propozimin për emërimin e anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----12,
Kundër ----- 36,
Abstenime ----- 13.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk e miratoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit.

9. Votimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale

Kryetari e hodhi në votim raportin e Komisionit për Integritet Evropian

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----62,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti me rekomandime i Komisionit për Integritet Evropian lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale.

10. Votimi i raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës

Kryetari e hodhi në votim raportin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----59,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Raporti me rekomandime i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.

11. Votimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2014

Kryetari e hodhi në votim raportin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----55,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti me rekomandime për performansën e ndërmarrjeve publike për vitin 2014.

12. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve

Kryetari i ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që t'i propozojnë anëtarët për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare. Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve, në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaku, nga GP i PDK-së, kryesuese,
2. _____, nga GP i LVV-së, zv.kryesues i parë,
3. Adem Hoxha, nga GP LS, zv.kryesues i dytë,
4. Hajdar Beqaj, nga GP i PDK-së, anëtar,
5. Alma Lama, nga GP i LDK-së, anëtare,
6. Melihate Tërmkolli, nga GP i LDK-së, anëtare,
7. _____, nga GP i AAK-së, anëtar,
8. _____, nga GP Nisma për Kosovën, anëtar,
9. Kujtim Paçaku, nga GP "6+", anëtar,

II. Ngarkohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit për Ankesa të Medieve që të veprojë në përputhje me nenin 38, paragrafët 2.2. dhe 2.3, të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur për Medie dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

13. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin financiar të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Armend Zemaj, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin.

Deputeti Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin financiar.

Lidhur me raportin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015 diskutuan: Nezir Çoçaj, në emër të GP të PDK-së; Agim Ademaj, në emër të GP të LDK-së, si dhe deputetët Abdyl Ymeri dhe Agim Aliu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për të proceduar me votimin e këtij raporti nuk pati kuorum. Andaj, kryesuesi votimin e shtyu për seancën e radhës.

* * *

Për raportin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015 është votuar në vazhdimin e seancën plenare, më 25 maj 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----63,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015.

14. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka shqyrtuar raportin e punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin financiar të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Fadil Demaku, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Komisioni FunkSIONAL për Punë të Brendshme, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin.

Deputeti Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin financiar të kësaj agjencie.

Lidhur me raportin e punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015 diskutuan: Ganimete Musliu, në emër të GP të PDK-së dhe Nuredin Ibishi, në emër të GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për të proceduar me votimin e këtij raporti nuk pati kuorum. Andaj, kryesuesi votimin e shtyu për seancën e radhës.

* * *

Për raportin e punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015 është votuar në vazhdimin e seancën plenare, më 25 maj 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----59,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015.

15. Shqyrtimi i raportit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ai e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin financiar për vitin 2015.

Ministri i Financave, z. Abdullah Hoti, e paraqiti dhe e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Lidhur me Raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015 diskutuan: Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të në emër të GP të LDK-së, Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së, si dhe deputetja Salihe Mustafa, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për të proceduar me votimin e këtij raporti nuk pati kuorum. Andaj, kryesuesi votimin e shtyu për seancën e radhës.

* * *

Për raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015 është votuar në vazhdimin e seancën plenare, më 25 maj 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----56,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

16. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar raportin e punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin.

Lidhur me raportin e punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015 diskutoi edhe deputetja Sala Berisha-Shala, në emër të GP të PDK-së, diskutimi i së cilës janë dhënë të plota në transkript.

Për të proceduar me votimin e këtij raporti nuk pati kuorum. Andaj, kryesuesi votimin e shtyu për seancën e radhës.

* * *

Për raportin e punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015 është votuar në vazhdimin e seancën plenare, më 25 maj 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----61,
Kundër ----- 5,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i punës i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015, me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

17. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar raportin e punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Armend Zemaj, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin.

Lidhur me raportin e punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015 diskutuan: Agim Aliu, në emër të GP të PDK-së dhe Agim Ademaj, në emër të GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për të proceduar me votimin e këtij raporti nuk pati kuorum. Andaj, kryesuesi votimin e shtyu për seancën e radhës.

* * *

Për raportin e punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015 është votuar në vazhdimin e seancën plenare, më 25 maj 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----53,
Kundër ----- 7,
Abstenime ----- 7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015.

18. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar raportin vjetor të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Deputeti Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin.

Lidhur me raportin e punës së Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015 diskutoi edhe deputetja Sala Berisha-Shala, në emër të GP të PDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Për të proceduar me votimin e këtij raporti nuk pati kuorum. Andaj, kryesuesi votimin e shtyu për seancën e radhës.

* * *

Për raportin vjetor të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015 është votuar në vazhdimin e seancën plenare, më 25 maj 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----62,
Kundër ----- 3,
Abstenime ----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i punës së Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015, me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 10:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale